



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.521/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Ymer Hoxha dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Anita Peci, duke vendosur përkritazi me ankesën e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal të Hanit të Elezit, Liridon Shiti, për shkak të manipulimit të votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 25.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e parregullt ankesa, ZL.A.nr.521/2017, e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal të Hanit të Elezit, Liridon Shiti, e paraqitur me datën 25.10.2017, për shkak të manipulimit të votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10. 2017

A r s y e t i m

Me datën 25.10.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Liridon Shiti, kandidatë për anëtarë të Kuvendit Komunal të Hanit të Elezit, me të cilën pretendon se ka dyshime se është bërë manipulim me vota, në Qendrën e Votimit 3304d.

Paneli, pasi që shqyrtoj paraprakisht lejueshmërinë e ankesave, gjeti se:

Ankesa është e pa rregullt

PZAP-i, nga shkresat e lëndës vlerësoi se, ankesa e parashtruar nga Liridon Shiti, kandidatë për anëtarë të Kuvendit Komunal të Hanit të Elezit, është e parregullt sepse nuk është e nënshkruar nga parashtruesi i ankesës dhe si e tillë ankesa nuk i plotëson kushtet siç kërkohen me nenin 5.6 të Rregullës nr. 02/2015, të PZAP-it, ku përcaktohet se: *Ankesat duhet të dorëzohen me shkrim dhe të jenë të nënshkruara nga ankuesi apo në emër të tij nga i autorizuari.*

Prandaj PZAP-i, nuk u lëshua fare në meritat e ankesës, ngase nuk janë plotësuar kushtet e kërkuar nga dispozita e lartë theksuar.

Nga arsyet e sipërshënuara e në mbështetje të nenit 5.6 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it dhe në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së, PZAP-i, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

ZL.Anr.521/2017 me datën 25.10.2017.



Kryesuese e Panelit
Gyltene Sylejmani

A handwritten signature in blue ink, appearing to be "Gyltene Sylejmani".

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.*